



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 329

Prishtinë, Dt. 06/02/2026

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Biologji
Projektpropozimi	"Flora vaskulare natyrore drunore dhe shkurre në pellgun e lumit Mirushë / Natural woody and shrubby vascular flora in the Mirusha River basin"
Kandidati	Vlora Ejupi Dina
Mentori	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 25.04.2025 Vendimi nr.: 1307

Vlerësimi i dorëshkrimit

Shënimet e përgjithshme

Punimi i nivelit të studimeve master i kandidatës Vlora Ejupi Dina ka 45 faqe tekst. Në punim janë paraqitur 15 figura dhe 2 tabela. Janë cituar 29 (burime nga literatura etj.). Punimi ka **abstrakt** dhe **rezyne** në të gjuhën shqipe dhe angleze. Në fund të punimit është **autobiografia** e kandidatës. Punimi përmban: **Hyrje** (faqe 13-14), **Qëllimi dhe rëndësia e punimit** (faqe 15), **Të dhëna të përgjithshme** (faqe 16-17), **Ndikimi i njeriut** (faqe 18), **Flora dhe vegjetacionin, vështrim i përgjithshëm** (faqe 19-20), **Materiali dhe metodat** (faqe 21), **Rezultatet** (faqe 22-33), **Diskutim** (faqe 34-35), **Përfundime** (faqe 36), **Literatura** (faqe 37-38), **Rezyne** (faqe 39-41), **Summary** (faqe 42-44), **Autobiografia** (faqe 45).

Analiza e Punimit

Në **Hyrje** kandidatja përshkruan në përgjithësi të dhëna përgjithshme për pellgun e lumit Mirushë, përfshirë edhe të dhëna të përgjithshme për florën dhe vegjetacionin.

Te "**Qëllimi dhe rëndësia e punimit**" arsyetohet qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit.

Në kapitullin "**Të dhëna të përgjithshme**", jepen të dhëna për pozitën gjeografike, gjeologjinë, pedologjike dhe për klimën e zonës së hulumtuar.

Ndikimi i njeriut, trajtohet në pjesë të veçantë.

Në kapitullin "**Flora dhe vegjetacionin, vështrim i përgjithshëm**" prezantohen informata për florën dhe vegjetacionin e zonës së hulumtuar, duke krahasuar gjendjen në terren me hulumtimet paraprake.

Materialin dhe metodat poashtu përshkruhen si pjesë e veçuar e punimit.

Rezultatet, si pjesë kryesore e punimit, paraqiten me detaje në formë liste shoqëruar me tabela e figura si të dhëna të mjaftueshme. Grupet e larta bimore janë renditur sipas filogjenisë, kurse kategoritë tjera sistematike (familjet, gjinitë dhe llojet) janë me renditje alfabetike.

"Format korologjike" dhe **"Format jetësore"** paraqiten si tabela e figura dhe komentohen.

Poashtu **"Fotografi të llojeve bimore"** janë prezantuar nga fondi i fotografive origjinale të llojeve nga zona e hulumtuar .

Edhe **diskutimi** dhe **përfundimet** prezantohen në pjesë të veçanta duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit.

Është cituar **literaturë** e mjaftueshme, e cila praktikehet për hulumtimin e taksonomisë së florës vaskulare.




Vlerësimi dhe propozimi

Bazuar në dorëshkrimin e punimit, Komisioni e vlerëson pozitivisht Punimin e masterit me titull "Flora vaskulare natyrore drunore dhe shkurreore në Pellgun e lumit Mirushë / Natural woody and shrubby vascular flora in the Mirusha River Basin" të kandidatës Vlora Ejupi Dina.

Sipas procedurës Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologjisë si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që ta pranojë propozimin dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit të lartëpërmenduar, me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Biologji).

Prishtinë, 06-02-2026

Komisioni:

1. 
/ Prof. Dr. Fadil Millaku – kryetar/
2. 
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – anëtar (mentor)/
3. 
/ Prof. Assoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.